



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 2338/1 Prot.

Tiranë, më 11.11.2024

Lënda: Dhënie mendimi mbi një projektvendim.

**KRYEMINISTRISË**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 5554/2 prot., datë 29.10.2024, administruar me tonën me nr. 2338 prot., datë 31.10.2024, përmes së cilës dërgohet për mendim projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore ‘Databaza e Treguesve të Statistikave Zyrtare’” së bashku me relacionin shpjegues, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Fillimisht, vërejmë se qëllimi i këtij projektvendimi është vënia në funksion e një baze të dhënash shtetërore elektronike për treguesit e statistikave zyrtare në mënyrë që përdoruesit (ku përfshihet përveç institucioneve shtetërore edhe publiku i gjerë) të mund të aksesojnë të dhëna statistikore, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së administratës publike.

Ndërkohë, pas analizimit të legjislacionit specifik, në zbatim të së cilit ushtron veprimtarinë INSTAT (në cilësinë e kontrolluesit), konkretisht ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” vërejmë se, ky i fundit legjitimohet të administrojë dhe të mbledhë informacione dhe të dhëna nga ndërveprimi me baza të tjera të dhënash shtetërore.

Gjithashtu, konstatojmë se INSTAT është pjesë e pikës 1, të Aneksit 1, të Udhëzimit të përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” i ndryshuar, i Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (botuar në Fletore Zyrtare nr. 135, datë 02.08.2024).

Për sa më lart, meqenëse proceset përpunuese të të dhënave personale të parashikuara në këtë projektvendim janë të një game të gjerë dhe përfshijnë disa institucione që do të jenë pjesë e këtij procesi, respektimi i parimeve dhe standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale përbën një detyrim thelbësor.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes në tërësi i projektvendimit, do të vlerësonim marrjen në konsideratë nga ana juaj edhe të sugjerimeve në vijim.

Së pari, shtimin e një pikë pas pikës 6, të projekt-vendimit me përmbajtje: *“Të dhënat që do të grumbullohen për krijimin e Databazës do të përpunohen në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale”*.

Lidhur me pikën 7, ku parashikohet niveli i aksesit, sugjerojmë të riformulohet duke saktësuar që të dhënat që përdoruesit do të kenë, konsistojnë vetëm në të dhëna statistikore dhe nuk mund të përpunohet asnjë e dhënë personale nga ky regjistër.

Me përfshirjen e sa më sipër, projektvendimi, vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**